
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	<b>Operatorë Ekonomik: Albi Company shpk me adresë në Rahovec</b>  <b>Operatorëve Ekonomik</b>  <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>29.04.2024</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **29.04.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Albi Company shpk** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHTANDEVE (TEZGAVE) MOBILE PËR MBAJTJEN E PANAIREVE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3589-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-034-5-2-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Albi Company shpk** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHTANDEVE (TEZGAVE) MOBILE PËR MBAJTJEN E PANAIREVE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3589-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-034-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **16.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
  
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I SHTANDEVE (TEZGAVE) MOBILE PËR MBAJTJEN E PANAIREVE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3589-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-034-5-2-1**
  
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Albi Company shpk** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHTANDEVE (TEZGAVE) MOBILE PËR MBAJTJEN E PANAIREVE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3589-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-034-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **16.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **29.04.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### BAZA LIGJORE E KËRKESËS

#### PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju si AK ku keni kërkuar kopje të noterizuar të kontratës së punës me punedhënesin në prani të paleve në si OE konsiderojmë se është në kundërshtim me piken a të paragrafit 8.5 të nenit 8 të Udhezimit Operativ nr 001-2023 pasi që në asnjë rrethane në këtë pikë nuk specifikohet që duhet ofruar kontratën e rregull të punës të noterizuar. Nëse kontrata e rregull e punës është kopje nga origjinali dhe kompania të njëjtin person e posedon në Listën e ATK-se atëherë janë dokumente me të mjaftueshme që të konfirmohet origjinaliteti i kontratës. Por juve si AK në pajtueshmëri me LPP ju lejohet që të verifikohen dokumentat pranë institucioneve ligjore perkatese dhe nëse konfirmohet se është dokument mjashgues-fiktive atëherë mund të percjellni kompanin pranë OSHP-se të cilet ju obligon LPP.

Nëse në si OE posedojmë Inxhinierin me kontratë si 10 vite dhe i njëjti është në listën e ATK-se, ku të njëjten kontratë e percjellim tek noteri, noteri nuk e noterizon pasi që kërkojmë që kontratë të perpilohet nga ana e noterit me atë datë të cilet paraqiten palet.

Andaj kërkojmë që nëse kontratë egziston si kontratë e rregull atëherë të mos është e nevojshme që të jete kopje e noterizuar.

---

#### PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

**Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 nuk qëndron.**

**Autoriteti Kontraktues** qëndron prapa kësaj kërkesë dhe nuk do e largoj të njëjtën nga Dosja e Tenderit, për arsye të përvojës së keqe që ka në raste të caktuara në Aktivitete të Prokurimit.

Në c ‘rast Operator Ekonomik ofertojnë me inxhinierë të cilët në fakt nuk jetojnë brenda vendit dhe veprimtarinë e tyre e ushtrojnë jashtë vendit ose edhe i njoftojnë AK që OE pa aprovimin e tyre i ka vendosur në listë të stafit. Pra për shkak të verifikimit dhe dëshmisë që personat e tillë janë në listë të stafit me pajtim ose marrëveshje të tyre është vendosur dhe vazhdon të vendoset kërkesa e tillë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmive është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabartë dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmive mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik**

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit